



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 21.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “NNP “CTA” shpk., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve“, Nr. i prokurimit- 632-26-5571-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-038-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET si e pasafatshme** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NNP “CTA” shpk., e dt.21.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve” Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 13.08.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET** dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, e publikuar me datë: 13.08.2026;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit, ashtu që Dosja e Tenderit mbetet në fuqi pa ndryshime.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njejtë publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “NNP “CTA” shpk., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve“, Nr. i prokurimit- 632-26-5571-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-038-511, .

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 24.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

Kërkesa për rishqyrtim është paraqitur jashtë afatit, andaj pretendimet tuaja nuk mund të merren në shqyrtim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik.